



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 493/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Kosova Turk Birligi (KTB) dega në Mamushë, paraqitur kundër subjektit politik Kosovo Turk Adalet Partisi (KTAP) dega në Mamushë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e Kosova Turk Birligi (KTB) dega në Mamushë .

### Arsyetim

Me datën 04.11.2013, Kosova Turk Birligi ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, në vendvotim (VV) janë lejuar të hynë pesë persona-vëzhguese KTAP, me qëllim që të krijohet rrëmujë për pengimin e votuesve në votim . Për më tepër ka shtuar se, vëzhguesit vazhdimisht i kanë penguar votuesit madje duke votuar në emër të tyre. Për gjitha këto veprime është lajmëruar kryesuesi i KKZ-së, duke shtuar se personat në KKZ janë në lidhje të afërt familjare

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### ankesa është e pa bazuar

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartëcekura nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nuk është ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë ankimorë, shikuar sipas dispozitës së nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it .

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 493/2013 më datën 06.11.2013.



Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi

### **Këshillë Juridike:**

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*